



## VENDIM

Nr.42 Datë 07.04.2015

### PËR

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LIÇENSËS ME NR.138, SERIA PV11K PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET E "PELLGUT TË OKSHTUNIT", ME FUQI 31,489 MW, TË SHOQËRISË "DITEKO" SH.P.K TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TE KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.114 DATË 16.11.2011.**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të "Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike", si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 gërma "b", pika 4 gërmat "a" dhe "b", të "Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave", të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma "a", të "Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s", miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.04.2015, mbasi shqyrtojë relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

### Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "DITEKO" sh.p.k, plotëson kërkesat ligjore siç kërkohen nga "Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave" si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma "a"** : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës. I plotësuar në mënyrë korrekte.
- **Neni 15, pika 4, gërma "b"** : Mungon Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti, bazuar në nenin 10, pika 10, neni 11, pika 1 të “ Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, ti paraqesë në ERE brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë proçedurat për modifikimin e liçensës me nr. 138, Seria PV11K, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec-et e “Pellgut të Okshunit” me fuqi 31,489 MW, të shoqërisë **“DITEKO”**, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.114 datë 16.11.2011.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**